



BULETINI I MUAJIT KORRIK 2025

Të dashur qytetarë,

Muaji korrik shënoi një periudhë intensive pune për Bashkinë Mirditë, ku pavarësisht sfidave të motit të nxehtë dhe përballjes me disa vatra zjarri, angazhimi ynë në shërbim të komunitetit ka vijuar pa ndërprerje.

Më poshtë gjeni një përmbledhje të angazhimeve dhe veprimtarive të realizuara.

Takim i hapur me të rinjtë.

Në kuadër të angazhimit për fuqizimin e të rinjve dhe përfshirjen e tyre në proceset vendim-marrëse, Këshilli Vendor Rinor Mirditë zhvilloi një takim të zgjeruar me të rinjtë e zonës.

Takimi shërbeu si një platformë e hapur diskutimi mbi sfidat, nevojat dhe prioritetet e të rinjve, duke sjellë ide konkrete dhe propozime për nisma që synojnë përmirësimin e jetës në komunitet.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, inkurajoi të rinjtë për një rol më aktiv në shoqëri si dhe prezantoi një nismë të re të Bashkisë Mirditë për mbështetjen e start-up-eve në fushën e turizmit dhe bujqësisë.

Thirrja për mbështetjen e start-up-eve me informacionin e plotë do të publikohet së shpejti.



Kampi Veror “Mirdita Vizion 2025” .

Bashkia Mirditë, në bashkëpunim me VIZION OJF, organizoi gjatë muajit korrik, kampin veror dyjavor “Mirdita Vizion 2025”, një hapësirë e rëndësishme për zhvillimin, argëtimin dhe edukimin e fëmijëve

Ky kamp u zhvillua me pjesëmarrjen e 85 fëmijëve, të cilët morën pjesë në aktivitete të ndryshme kreative, sociale dhe edukative, duke përjetuar ditë të mbushura me gëzim, energji pozitive dhe bashkëpunim.

Ceremonia përmbyllëse u kurorëzua me ndarjen e certifikatave për fëmijët, në një atmosferë festive dhe inkurajuese. E pranishme në aktivitet ishte edhe znj. Nora Malaj, e cila përçoi mesazhe edukuese dhe frymëzuese, duke nxitur besimin dhe dëshirën për të mësuar te më të vegjlit.

Bashkia Mirditë shpreh mirënjohje për stafin e VIZION OJF dhe QKF-Mirditë, të cilët me përkushtim dhe profesionalizëm bënë të mundur një organizim të shkëlqyer të këtij kampi që u kthye në një eksperiencë të paharrueshme për fëmijët pjesëmarrës.



Bashkia Mirditë fituese në thirrjen e programit ReLOaD3!

Bashkia Mirditë është shpallur fituese në thirrjen e programit ReLOaD3, të financuar nga Bashkimi Evropian dhe të zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP).

ReLOaD3 synon të forcojë demokracinë vendore përmes bashkëpunimit të pushtetit vendor dhe organizatave të shoqërisë civile, duke rritur njëkohësisht pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Përfitimet për Bashkinë Mirditë përfshijnë:

- Rritje të kapaciteteve institucionale.
- Asistencë teknike nga ekspertë të programit.
- Mbështetje financiare për nxitjen e partneriteteve me organizatat e shoqërisë civile në ofrimin e shërbimeve publike duke u bazuar në prioritetet vendore.

Ky projekt do të sjellë përfitime konkrete për komunitetin, nëpërmjet bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile.



#ReLOaD3

Regional Programme on
Local Democracy in the
Western Balkans



Punët e dobishme në shërbim të komunitetit.

Në Perlat, Njësia Administrative Kthellë, po punohet për ndërtimin e urës së tipit Bailey.

Kjo ndërhyrje do të përmirësojë infrastrukturën rrugore dhe do të lehtësojë lëvizjen në një zonë me terren të vështirë dhe akses të kufizuar.

Falenderojmë Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura për bashkëpunimin, në mbështetje të komunitetit tonë.



Punët e dobishme në shërbim të komunitetit.

Kanë përfunduar punimet për asfaltimin e rrugicave pranë pallateve Parafabrikat dhe pallateve të Fermës në Rrëshen, me qëllim përmirësimin e infrastrukturës dhe lehtësimin e aksesit për qytetarët.



Ekspozita e Muzeut Historik në Mirditë.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. Albert Melyshi, mirëpriti sot përfaqësuesit e Muzeut Historik Kombëtar në Mirditë.

Gjatë takimit u diskutua për nevojën që Bashkia Mirditë ka për të promovuar pasurinë historike të zonës dhe për të përmirësuar Muzeun Historik të Mirditës.

Ekipi i njësisë së edukimit të Muzeut Historik Kombëtar, i udhëhequr nga Drejtoresha znj. Elenita Roshi, zhvilloi një sërë aktiviteteve edukative dhe argëtuese me fëmijët e qytetit të Rrëshenit, të cilat kulmuan me hapjen e ekspozitës fotografike “Thesaret e Muzeut”. Kjo ekspozitë solli para tyre disa nga objektet më të çmuara të koleksionit të Muzeut Historik Kombëtar.

Kryetari i Bashkisë Mirditë, i falënderoi përfaqësuesit e Muzeut për bashkëpunimin, duke theksuar rëndësinë e këtyre iniciativave që fuqizojnë njohuritë historike dhe kulturore tek brezat e rinj.



Festivali “KAH DRITA”

Në datat 19 dhe 20 korrik 2025, në qytetin e Junikut u zhvillua festivali kulturor “KAH DRITA”, një ngjarje ku u ndërthurën kultura, trashëgimia, arti dhe bashkëpunimi ndërkufitar.

Ansambli “Mirdita” solli këngë, valle dhe traditat autentike të Mirditës, duke i prezantuar ato para një publiku të gjerë dhe duke i dhënë festivalit një dimension të veçantë kulturor.

Ky festival është pjesë e projektit “Mirdita Junik”, që ka si qëllim nxitjen e turizmit të qëndrueshëm, dhe mbështetet nga Bashkimi Evropian në kuadër të programit për bashkëpunim ndërkufitar Shqipëri–Kosovë, dhe që zbatohet në partneritet nga CHwB Kosova, Bashkia Mirditë, Komuna Junik dhe Qendra UET.



Muzeu Historik i Mirditës.

Vijon procesi i punës në Muzeun Historik të Mirditës, për t'a kthyer në institucion të rëndësishëm, ku do të ekspozohet një pjesë e trashëgimisë së pasur të krahinës, si dëshmi e vazhdimësisë së kulturës materiale që nga prehistoria...




Mirdita shkëlqen me pasuritë e saj natyrore.

Më 11 korrik 2025, një ekip speleologësh realizoi një eksplorim nënujor në shpellën “Kusia e Nue Gjonit” në Kurbnesh, duke zbuluar lidhjen midis dy liqeneve të brendshme dhe arritur një thellësi prej 11 metrash.

Nën drejtimin e speleologëve Roland Doja dhe Alket Camaj, ekspedita u zhvillua me pjesëmarrjen e zhytësve, studiuesve, përfaqësuesve të Info-Kullës dhe të rinjve pasionantë, duke theksuar rëndësinë turistike dhe shkencore të shpellës.

Kjo ekspeditë shënon një hap të rëndësishëm për speleologjinë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri – duke vendosur Mirditën si një pikë referimi për natyrën, aventurën dhe zbulimet e reja.





INVESTO NË MIRDITË

Datë: 12 Gusht 2025

Ora: 10:00

Vendi: Agroturizëm "Arbëri".

Email: info@bashkiamirdite.gov.al

Tel: +355 216 22 233

FTESË PËR PJESËMARRJE

Bashkia Mirditë ju fton të merrni pjesë në aktivitetin "Investo në Mirditë", që do të zhvillohet më 12 Gusht 2025, ora 10:00, në bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, pranë Agroturizëm "Arbëri" Rrëshen.

Ky takim i hapur synon të krijojë një bashkëpunim institucional për zhvillimin ekonomik dhe turistik të Mirditës, mbi bazën e aseteve ekzistuese dhe mundësive konkrete për përdorimin e tyre, si dhe në kuadër të nismës "Paketa e Maleve".

Ftojme të gjithë mirditorët / investitorë të tjerë që me përvojën e tyre dëshirojnë të kontribuojnë dhe të investojnë në Mirditë me projekte konkrete biznesi apo dhe në fushën sociale.

Për konfirmim pjesëmarrjeje ose për më shumë informacion, ju lutemi kontaktoni në: info@bashkiamirdite.gov.al / +355 216 22 233.

Bashkia Mirditë

Zëri i Komunitetit.

Ne besojmë se secili prej nesh ka një histori, një iniciativë apo një shembull pozitiv që mund të frymëzojë të gjithë komunitetin tonë.

Në këtë seksion, ju ftojmë të na dërgoni:

- Ide për projekte komunitare.
- Historitë tuaja personale të sukseseve dhe angazhimit.
- Mesazhe për bashkëqytetarët.
- Foto ose video nga aktivitetet që organizoni.

Si të kontribuoni?

Dërgoni mesazhin tuaj në email-in: info@bashkaimirdite.gov.al ose kontaktoni në numrin: +355 216 22 233

